
NEKROLOGJI

ALAIN DUCELLIER

(*In memoriam*)

(1938-2018)



Këto ditë u nda nga jeta prof. Alain Ducellier, historian francez, bizantolog e albanolog ndër më të shquarit e shek. XX. Alain Ducellier u formua në shkollën e mjeshtrit të madh të studimeve bizantine, Paul Lemerle, dhe për shumë vjet drejtoi Institutin e Studimeve Bizantine në Universitetin *Le Mirail* të Toulouse-s. Është autor i më se 20 monografive dhe i një numri shumëfish artikujsh shkencorë mbi Bizantin e botën bizantine, përkthyer e botuar në disa gjuhë e në revistat më të njohura shkencore të specializuara. Solli një qasje të re metodologjike në këto studime, duke u nisur nga

periferitë për të shkuar drejt qendrës së Perandorisë duke i kushtuar një vëmendje, deri atëherë të munguar, provincave bizantine. Kështu, falë njohjes sovrane të gjuhëve e të kulturave të të gjithë popujve të përfshirë në Perandorinë Bizantine, Ducellier zbuloi dhe tregoi historitë “arabe”, “sllave”, “greke”, “italiane” e sidomos “shqiptare” të asaj Perandorie.

Pikërisht në kuadrin e hulumtimeve të tij për historinë bizantine, A. Ducellier e tërhoqi veçoria e jashtëzakonshme e Shqipërisë, kësaj province periferike të Perandorisë Bizantine që qëndronte midis Lindjes e Perëndimit dhe që kontrollonte arteriet kryesore të komunikimit midis Romës së Lindjes dhe Romës së Perëndimit, rrugën *Egnatia* e Kanalin e Otrantos. Studimet e shumta për Shqipërinë që rezultuan nga interesi i tij shkencor për të dhe për popullin e saj, i dhanë atij emrin e njohësit *absolutisht më të mirë të Mesjetës shqiptare* (Paul Gautier). Mes tyre shquhet vepra monumentale *Fasada bregdetare e Shqipërisë në Mesjetë: Durrësi dhe Vlora nga shek. X në shek. XV* (1981), të cilën Paul Lemerle e ka quajtur *kontribut të çmuar për historinë kombëtare të Shqipërisë, realizuar nga një studiues i pajisur me kuriozitet historik të jashtëzakonshëm dhe me sens të hollë për të kapur e për të vlerësuar ndikimet e ndërveprimet, përqasjet e kundërvëniet.*

Kjo vepër, së bashku me *Shqipëria midis Bizantit e Venedikut* (1989) e të tjera studime të Alain Ducellier, ndërsa marrin në analizë marrëdhëniet e shqiptarëve me botën lindore bizantine dhe me atë perëndimore latine, vendosin në qendër të saj pikërisht shqiptarët, institucionet e strukturat e tyre politike, sociale, juridike. Jo vetëm, por i bindur në rëndësinë e posaçme gjeopolitike të shqiptarëve, në veprat përgjithësuese kushtuar historisë së Perandorisë Bizantine, si *Bizanti dhe bota ortodokse*, *Bizanti shek. IV-XV*, *Evropa tjetër*, *Konstandinopoja* etj., A. Ducellier i ka dhënë vend të dukshëm edhe Shqipërisë dhe shqiptarëve, gjë që bizantinistë të tjerë nuk e kishin bërë më parë.

Vepra albanologjike e A. Ducellier përmban risi të rëndësishme në krahasim me studiues të tjerë të shquar të historisë mesjetare shqiptare, siç janë C. Jireçek e M. Šufflay. Ducellier nuk e kufizoi objektin e analizës së tij vetëm në hapësirën e shtetit të Arbërit, të përfshirë brenda katërkëndëshit Vlorë-Ohër-Prizren-Tivar. Ai e hetoi faktorin shqiptar në të gjithë hapësirën jetësore të tij: në territoret e shtetit të sotëm të Shqipërisë, në Kosovë, në Mal të Zi e në Epirin e Vjetër. Përveç kësaj, në një sërë studimesh të posaçme Ducellier ka shkruar historinë e emigracionit mesjetar shqiptar në Greqi, në Italinë e Jugut, në Marke, në Venedik, në Dalmaci (*Shqiptarët në Greqi në shek. XIII-XV; Rrugët e mërgimit. Përmbysjet e mëdha në Evropën Lindore dhe valët emigruese drejt Perëndimit në fund të Mesjetës*). Si ndjekës i “*Shkollës së Analeve*” të themeluar nga Marc Bloch, e cila revolucionarizoi historiografinë moderne, ai zbatoi metodat më të përparuara të kërkimit shkencor, siç është ajo e përkufizimit gjeografik të objektit të studimit (gjeografia historike), dhe e analizës shumëplanëshe: gjeopolitike, ekonomike, sociale e etnokulturore. Vepra e tij ka zbuluar, ka plotësuar, ka rektifikuar dhe ka riinterpretuar momente të rëndësishme të Mesjetës shqiptare. Ducellier nuk u mjaftua të ishte ai vetë studiuesi i apasionuar i Mesjetës shqiptare. Ai e ktheu Institutin Bizantinistik të Universitetin të Tuluzës, në një shkollë ku nën drejtimin shkencor të tij u formua një aradhë e tërë historianësh albanologë, si Brunehilde Imhaus, Bernard Doumerc, Christine Minvielle-Debat, Jean de Miceli e të tjerë. Nga ana e tyre, të gjithë këta u bënë autorë e bashkautorë veprash të rëndësishme për Mesjetën shqiptare.

Duke filluar nga viti 1962, Alain Ducellier ka vizituar shumë shpesh Shqipërinë. Ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare të organizuara nga Akademia e Shkencave në Tiranë, si në Konferencën II Albanologjike mbi Gjergj Kastriotin-Skënderbeu (1968), në Konferencën mbi Shtetin e Arbërit (1990), në Konferencën mbi Kosovën (1993). Ai ka vizituar qendrat historike e arkeologjike, nga veriu në jug të vendit, duke fituar një njohje të shkëlqyer të terrenit që i ka shërbyer mjaft inkuadrimit të saktë të ngjarjeve të përshkruara në studimet e tij mbi Shqipërinë mesjetare.

Për meritat e tij të veçanta në studimin e historisë së Mesjetës shqiptare Alain Ducellier është nderuar me mirënjohje të larta të shtetit shqiptar. Ai është

Anëtar Nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila pikërisht disa ditë para ndarjes nga jeta e regjistroi emrin e prof. Alain Ducellier në “Librin e Artë të Meritës në Albanologji”.

Pëllumb XHUPI